



Save the Children

MËSUESI

“Fëmijët dhe të rinjtë flasin”

NR 5 Shtator 2010

Fëmijët, në ndërtimin e paqes



Në datat 13-19 qershor në Bosnje-Hercegovinë (Sarajeva) u zhvillua një workshop. Ky workshop kishte si qëllim pjesëmarrjen e fëmijëve në ndërtimin e paqes në nivel nacional, rajonal dhe ndërkombëtar si dhe shmangien e dhunës dhe konflikteve. Shtetet pjesëmarrëse ishin: Shqipëria, Serbia, Mali i Zi, Palestina, Rumania dhe Bosnja-Hercegovina.

Pjesëmarrësit e workshopit nga Shqipëria ishin pesë veta: Suela Bala drejtuese koordinatore e organizatës Save The Children në Tiranë. Nertila Topulli, drejtoreshë në qendrën për fëmijët e rrugës. Suela Hoxha, monitoruese në qendrën për fëmijët e rrugës. Albana Zejnelloxha, punonjëse për qeveritë e nxënësve në Drejtorinë Arsimore Rajonale në Elbasan. Alba Merdani, nxënëse në klasën e tetë në shkollën “Xhaferr Kongoli” në Elbasan, senatore klase dhe pjesëtare në qeverinë e nxënësve.

Gjatë këtij workshopi u zhvilluan aktivitete të ndryshme, ushtrime dhe punë në grup, ku në qendër të vëmendjes ishin paqja, dhuna dhe konflikti. Ideja ishte që të njiheshim me vështirësitë gjatë ndërtimit të paqes. Duhet të gjenim të gjitha zgjidhjet e mundshme se si mund t’ia ndanim një portokall dy fëmijëve kur secili e kërkonte atë.

U zhvillua ushtrimi me trekëndësh. Në çdo kulm të tij duhet të shkruanim: 1- se si ndjehemi përballë një konflikti 2- çfarë bëjmë kur ndodhemi përballë një konflikti 3- si formohet konflikti.

U bë ushtrimi me brainstorming. Duhet të shkruanim se çfarë fjalësh na vinin ndërmend kur përmendim fjalët dhunë dhe konflikt. U bë një tjetër ushtrim me trekëndësh mbi dhunën: 1- dhunë direkte 2- dhunë e strukturuar 3- dhunë kulturore, ne duhet të jepnim shembuj për çdo rast.

Në fillim të workshopit vendosëm

disa rregulla që duhet të zbatoheshin nga të gjithë gjatë gjithë workshopit. Do të bënim me vizatim se cili është vizioni ynë për paqen në nivel nacional dhe ndërkombëtar. Grupi përfaqësues i Shqipërisë vizatoi shqiponjën si simbol kombëtar dhe për të treguar barazinë duke qenë se shqiponja është simetrike. Brenda saj vizatoi simbolin e paqes dhe për çdo shkronjë shkruajti nga një cilësi që duhet për të arritur paqen. Anash vizatoi dhe disa fëmijë me ngjyrë për të dhënë idenë e shoqërisë në çdo vend të botës.


Në një tjetër punë me grupe duhet të shkruanim se çfarë nënkuptonte qytetaria për ne dhe çfarë të drejtash, rregullash dhe përgjegjësish kemi ne si qytetarë. Për çdo rast duhet të je-

Gjatë workshopit u zhvilluan dhe mjaft lojëra për ta bërë sa më të gjallë pjesëmarrjen e fëmijëve, të rinjve dhe të rriturve në workshop.

Pjesëmarrja në këtë workshop ishte një mundësi shumë e mirë për mua për të mësuar gjëra të reja mbi kulturën e shteteve pjesëmarrëse dhe punën e tyre duke përfshirë fëmijët në ndërtimin e paqes dhe shmangien e konflikteve. Pjesëmarrja në këtë workshop ishte një eksperiencë e re për mua. Krijova miqësi të reja me fëmijët dhe të rinjtë nga vendet pjesëmarrëse. Më dha një mundësi shumë të mirë për të praktikuar më shumë gjuhën angleze në të folur dhe në të shkruar. Mësova se me këmbëngulje dhe durim mund të arrish çdo gjë që

dëshiron. Mësova më shumë lojëra dhe mënyra më të mira për të punuar në grup. Mësova se pjesëmarrja e fëmijëve në shkollë, në komunitete, etj. është e rëndësishme në shmangien e konflikteve dhe arritjen e paqes.

Gjithë njohuritë e marra gjatë workshopit në Sarajevë do mundohem t’i vë në zbatim. Dëshiroj që mësimet e marra t’ia transmetoj senatorëve të tjerë në shkollën ku unë mësoj. Dëshiroj t’iu mësoj atyre dhe t’i përcjell gjithë eksperiencën time dhe njohuritë e fituara atje. T’i tregoj lojërat që ne zhvilluam atje, ushtrimet dhe gjithë punët në grupe. Dëshiroj që dhe ata të dinë rëndësinë e pjesëmarrjes së fëmijëve



pnim nga një shembull.

Ishte puna me hartën e trupit, rrejetën e merimangës, me pemën dhe me balonën. Të ndarë sipas grupeve do të plotësonim çdo pjesë të vizatimeve sipas udhëzimeve përkatëse, por qëllimi ishte të nxirrnim anët pozitive dhe negative të një konflikti apo gjatë arritjes së paqes.

Puna e fundit konsistonte me hartën e rrethit ku duhet të shkruaje se çfarë mund të bëjmë ne si fëmijë për të arritur paqen me veten, në familje, me shokët, në lagje, në komunitet, në shtet, në rajon dhe në botë.



PJESËMARRJA

Gjatë workshopit u zhvilluan dhe mjaft lojëra për ta bërë sa më të gjallë pjesëmarrjen e të rriturve

jëve në ndërtimin e paqes dhe shmangies së konflikteve dhe dhunës. Dua t’i njoh ata dhe me punën që kanë bërë shtetet e tjera pjesëmarrëse për paqen, dhunën dhe konfliktet. Dua t’i përcjell atyre të gjitha konceptet e mësuara mbi paqen, dhunën dhe konfliktin. Dëshiroj që t’i nxis ata me njohuritë e fituara në këtë workshop të jenë aktivë në vendimet në lidhje me shkollën apo komunitetin. **Punoi: Alba Merdani**
Klasa e VIII
Shkolla: “Xhaferr Kongoli”, Elbasan

Zëri 16... i kane mëshuar punës në lidhje me të drejtën e arsimit, duke e quajtur atë vendimtare për jetën dhe të ardhmen e një fëmije



Foto ilustruese

Fëmijë që nuk arrijnë të vazhdojnë shkollën e mesme një pjesë do të merren me punët e shtëpisë, një pjesë do të emigrojnë, një pjesë do të formojnë familje

Zëri 16+...Peshkopi, është një grup fëmijësh që promovon dhe lobon për të drejtat e fëmijëve në rajonin e Dibrës i mbështetur nga Save the Children. Ata kanë filluar veprimtarinë e tyre para katër vitesh në qytetin e Peshkopisë ndërsa tashmë synimet dhe puna e tyre po shtrihet jashtë kufijve të qytetit, duke u zgjeruar në rajon për të identifikuar problemet dhe nevojat e fëmijëve.

Ata kanë konstatuar që është shumë e rëndësishme për fëmijët të dinë dhe të kërkojnë respektimin e të drejtave të tyre, po ashtu ata mendojnë se këtë gjë duhet ta dinë dhe mësuesit dhe prindërit, krahas kësaj ata kanë identifikuar dhe listuar problematikën e fëmijëve të rajonit, si:

1. Mungesa e një qendre rimore në qytetin e Peshkopisë.
2. Mungesa e një qendre trajtimi për fëmijët me aftësi të kufizuara.
3. Mungesa e një personeli të kualifikuar për çështjet e fëmijëve me probleme sociale.
4. Pamundësia e trajtimit të fëmijëve me aftësi të veçanta,

“Zëri 16...” me fëmijë e Peshkopisë në veprimtari edukuese

nëpërmjet kurseve ekstra.

5. Ngritja e cilësisë së mësimdhënies në shkollat 9-vjeçare dhe sidomos të mesme.

6. Zhvillimi i dezhurnit dhe pastrimi në shkollat në fshatra, nga vete fëmijët etj

Jo pak ata i kane mëshuar punës në lidhje me të drejtën e arsimit, duke e quajtur atë vendimtare për jetën dhe të ardhmen e një fëmije dhe pse jo dhe të tërë shoqërisë.

Nga fëmijët e zërit 16 + është identifikuar një

problem jo i vogël, në lidhje me realizimin e kësaj të drejte për shumë fëmijë që mbarojnë arsimin 9-vjeçar dhe nuk vazhdojnë arsimin e mesëm, ata zhvilluan një pyetësor në 203 nxënës në me fëmije të moshës 15-18 vjeç për të studiuar fenomenin dhe për të evidentuar shkaqet që shkaktonin këtë gjendje, ku rezultoi se kjo situatë vjen për shumë arsye ndër të cilat, mungesa e një shkollë të mesme në zonën e tyre, (pohojnë 90% e të intervistuarve) problemet

ekonomike në familje, (pohojnë 100% e të intervistuarve), mentaliteti për të dërguar vajzat në shkollë, (pohojnë 23% e të intervistuarve) ndoshta dhe të tjera.

Këta fëmijë që nuk arrijnë të vazhdojnë shkollën e mesme një pjesë do të merren me punët e shtëpisë një pjesë, (pohojnë 47% e të intervistuarve), do të emigrojnë në rrugë të paligjshme, (pohojnë 46% e të intervistuarve), një pjesë (vajzat) do të formojnë familje që në moshë

minorene, (pohojnë 20% e të intervistuarve).

Ky fenomen është kryesisht në zonat rurale, në fshatra si Fushe – Çidhën, Kala e Dodes, Luzni, selishte, ku dhe fëmijët e atyre zonave kane të drejte të arsimohet si bashkëmohatarët e tyre të cilat përmes shkollës krijojnë perspektiva të tjera për të ardhmen e tyre.

Në takime me mësues të këtyre zonave sheh shqetësimin që kanë ata për këtë fenomen, por jo rrallë has dhe mendime të tilla si “5-6 fëmijë janë në një klasë që nuk shkojnë në shkollë të mesme, nuk janë shumë”, por në çdo klasë 5-6 fëmijë dhe çdo vit e vit pas viti sa të tilla bëhen...?, e të mos harrojmë se këta janë pjesë e shoqërisë sonë,

zëri 16+.....Peshkopi, bën apel në emër të këtyre fëmijëve, që dhe ata të kenë mundësinë e shkollimit të tyre në arsimin e mesëm pse jo dhe te lartë, ndoshta është koha të përshpejtohen procedurat e bërjes së arsimit të mesëm të detyruar.

ZERI 16+PESHKOPI

Raport per aktivitetet verore 15 korrik-31 gusht 2010

Shpesh, për fëmijët, edhe pse s'vëra ka mbetur larg dhe iu janë kthyer klasave dhe mësimëve, veprimtaritë shlodhëse të saj i kanë ende të freskëta. Pikërisht për të tilla do flas edhe në shkrimin e mëposhtëm. Zyra për Mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Bashkinë Elbasan organizoi dhe këtë vit kampin veror për fëmijët në nevojë. Mbështetja financiare për organizimin e aktiviteteve u realizua nga fondacioni Terre des Hommes dhe Regione Emiglia Romanja. Në kamp morën pjesë 140 fëmijë nga moshë 3-18 vjeç. Aktivitetet e zhvilluara gjatë kampit ishin të

Problem	Solution	Stakeholders	Timeline
Conflict situations arising in schools as a result of discriminatory and violent	<ul style="list-style-type: none"> * CG and CLG build peer-to-peer relationships * CLG's capacities raised in peer-to-peer training & peer-to-peer training * CLG mentoring CG (Family) * REA (local government) 	Children, Parent, Community teachers, Local authorities, Local youth NGO's, NGO's representing	3 years 2010-2012 2010-2011

larmishme ato u programuan nga mësuesit dhe animatorët në përputhje me moshën, nevojat dhe dëshirat e fëmijëve. Në këtë kontekst u zhvilluan aktivitete me qëllim përgatitjen e fëmijëve për në klasë të parë, aktivitete manuale si: vizatim, ngjyrosje, punime me aplikacione, me materiale të ricikluar, qëndisje, punime artizanale; Risi në këtë kamp veror ishin organizimi i aktiviteteve psiko-sociale të organizuar nga animatorët e trajnuar nga projekti MOVE. Pjesë e këtyre aktiviteteve ishin dhe sesionet sensibilizuese jo vetëm me fëmijët pjesëmarrës, por dhe me prindërit lidhur me

të drejtat e fëmijëve, rëndësinë e arsimit, e higjienës personale, prindërimin pozitiv etj. Fëmijët patën mundësinë të marrin pjesë dhe në disa ekskursione jashtë qytetit si në: Apolloni, Durrës, Pogradec. Në këto ekskursione, ata jo vetëm u zbavitën por edhe njohën vlerat kulturore dhe historike të vendit tonë. Ajo që vlen të theksojmë është fakti që 54 fëmijë pjesëmarrës në këtë kamp regjistruan në klasë të parë dhe për herë të parë këta fëmijë Rrom janë të përgatitur njësoj si bashkëmohatarët e tyre, falë njohurive të marra në kopshtin e hapur rishtas pranë komunitetit të tyre dhe shprehive të mësuara gjatë aktiviteteve verore. Përfundimi i këtyre aktiviteteve verore, u finalizua me një aktivitet artistik në qendër të qytetit. Në këtë aktivitet u promovuan punimet e fëmijëve përmes një ekspozite të cilën e vizituan një pjesë e mirë e qytetarëve Elbasanas. Gjithashtu fëmijët dhanë një program artistik të përgatitur nga vetë ata. Të pranishëm në këtë festë fëmimore ishin dhe autoritete lokale si: kryetari i Bashkisë Elbasan, përfaqësues nga DAR, përfaqësues nga Qarku, Prefektura dhe nga shoqatat që veprojnë në qytetin e Elbasanit Aktivitetet verore u zhvilluan në ambientet e Qendrës komunitare rrome dhe kishin si qëllim argëtimin, edukimin dhe mbi të gjitha mbrojtjen e fëmijëve në nevojë.

Nadire Kreka, Elbasan



AKTIVITETI

Me mbërritjen tone atje, e kuptuam që nuk ishte thjesht një shëtitje dhe kjo vizitë na bëri të ndihemi me të përgjegjshëm se kishim kryer një veprim qytetar, një akt dashurie e kujdesi që duhet ta kishim bërë më shpesh dhe e ndjemë veten shumë të emocionuar



Veprimtari nga shkolla 9-vjeçare “Lef Sallata”

Kur na tha mësuesja koordinatore se pas mbarimit të mësimit do të fillonim një dyjavor aktivitetesh në shkollë. Reagimet ishin të ndryshme. Më të mëdhenjtë, nxënësit e klasave të nënta, që kishin dëgjuar për të, (sic na thanë ishte organizuar edhe para dy vjetësh në shkollë), u munduan të na e shpjegonin.

Thjesht ata na thanë se këto dy javë në shkollë do të ishin kënaqësi për ne pasi do të kryenim aktivitete e lojra të ndryshme dhe do ta kalonim këndshëm orën. Sigurisht lojtaret e apasionuar të kompjuterit, djemtë nuk e pritën mirë sepse e llogarisin kohën e tyre të lirë vetëm me sa orë kompjuter mund të luajnë në ditë.

Nga sa vume re, në takimin që bëmë me senatorët për të diskutuar mbi planin e aktiviteteve, më entuziastët, ishin nxënësit e klasave të gjashta e të shtata. Të nëntat justifikoheshin, janë në sezon provimi.

Plani përmbante aktivitete të ndryshme por ai që na tërhoqi më tepër vëmendjen ishte të shkonim një vizite në Shtëpinë e Fëmijës në Vlorë. (sigurisht jo me duar bosh)

Nuk po pershkruaj të gjitha aktivitetet, por vetëm këtë të fundit pasi më bëri më tepër përshtypje.

Deri në ditën e caktuar për të shkuar atje, ne kishim bërë c'është e mundur për të mbledhur dhurata të ndryshme, madje pronari i një lokali pranë shkollës na fali një numër kutish me dhurata për fëmijë.

Ju nuk e dini por Shtëpia e Fëmijës në Vlorë gjendet në Ujin e Ftohtë, në një nga pozicionet me të bukura

të qytetit, me detin përballë. Është pak larg nga shkolla jonë, por kjo na e shtonte gëzimin. Shumica nuk kishin shkuar ndonjëherë atje dhe e shihnin thjesht si një shëtitje të këndshme.

Sigurisht që me mbërritjen tone atje, e kuptuam që nuk ishte thjesht një shëtitje dhe kjo vizitë na bëri të ndihemi me të përgjegjshëm se kishim kryer një veprim qytetar, një akt dashurie e kujdesi që duhet ta kishim bërë më shpesh dhe e ndjemë veten shumë të emocionuar.

Fëmijët e vegjël, na shikonin fillimisht të habitur, por me pas shumë prej tyre u shpërndanë në krahët tona dhe luain të shkujdesur. U gezuam

kur panë se ne u kishim cuar dhurata, por kam përshtypjen se më tepër ata u gëzuar për praninë tonë. Mua me mbeti ne mendje një fëmijë i vogël, më i vogli i të gjithëve, ai ishte dhe me i gëzuari.

Ishte një pamje që në nuk do ta harrojmë kurrë. Disa fëmijë kërcenin nga gëzimi, disa të tjerë merreshin me lodrat e reja. Megjithatë na thanë që në katin sipër kishte fëmijë më të vegjël që po flinin dhe ne nuk duhet të bënim shumë zhurmë.

Kur u kthyem që andej ishim të trishtuar dhe të gëzuar në të njëjtën kohë. Ne nuk do t'i harrojmë kurrë ata sy të vegjël plot shkelqim, dhe ata fëmijë me të cilët fati

nuk është treguar i drejtë.

Pas kësaj nuk bisedonim për gjë tjetër dhe përshtypjet i cuam edhe në shtëpitë tona.

Ky ishte vërtet aktiviteti më mbreselënës i javës, por ne ditë të tjera aktivitetet u zhvilluan njeri pas tjetrit dhe jo vetëm që ne kaluam shumë mirë por numri i nxënësve vinte duke u shtuar çdo ditë. Një aktivitet tjetër ishte planifikuar për promovimin dhe njohjen me të drejtat e fëmijëve. Për këtë u gjet një mënyrë origjinale. Në muret e jashtme të shkollës, krahas pikturave simbol që kishin lenë klasat e nënta, u shkruan nene të ndryshme të Konventes së Fëmijëve dhe vizatime të ndryshme që i

ilustronin ato. Për këtë na ndihoi mesuesja koordinatore e cila është edhe mësuese vizatimi. Ajo bënte skicat me laps dhe ne i plotesonim me ngjyra. Me bluza të bardha e kapele dukëshim si piktorë të vegjël dhe ishte shumë interesante të pikturoje muret. Dukeshin edhe bukur!

Nuk ka nevojë të perseris edhe njëherë se të gjithë në shprehëm dëshirën të vazhdonim edhe disa ditë këto aktivitete por mësuesja na tha se do të punonte me dokumentacionin dhe do të na duhej të prisnim fundin e vitit tjetër për të kaluar një eksperiencë të tillë.

Xhenovefa Kruta,
klasa VI



Qeveria e Nxënëve & Save the Children në shkollën "Neim Babameto"

Ne jemi përfaqësuesit e Qeverisë së Nxënëve se në shkollën 9-vjecare "Neim Babameto" të qytetit të Durrësit. Shkolla jonë është një ndër shkollat më të mëdha të qytetit tonë.

Që prej kohësh ne mësojmë në një ndërtesë të re. Fakti që nxënësit e shkollës dhe komuniteti që na rrethon ka përbërje heterogjene bën që në shkollën tonë nxënësit të sjellin kulturat të ndryshme. Ne jemi përfshirë në projektin kundër dhunës nga shoqata Save the Children. Shtrirja e këtij projekti ka ndikuar shumë në procesin edukativ të nxënëve të kësaj shkolle. Literaturë e shpërndarë të mësuesit, nxënësit, komuniteti si dhe aktivitetet e ndryshme kanë ndikuar pozitivisht në ndërgjegjesimin e tyre në minimizimin e dhunës gjatë procesit mësimor në lëndë të ndryshme.

Mesazhet kundër dhunës janë përcjellë në lëndë e forma të ndryshme.

1-Gjuha shqipe-Propovimi i librit me krijime të nxënëve në poezi dhe prozë me temë kundër dhunës.

Botimi nga Qeveria e Nxënëve në cdo 2 muaj i gazetës së shkollës e cila përmban krijimtari të vetë nxënëve.

Akrimet e nxënëve të krijuara nga vetë ata.

Eshtë këmbëngulur që nxënësit e kësaj shkolle të flasin e të shkruajnë sa më bukur gjuhën letrarë shqipe dhe këtë gjë ta përcjellin edhe në familjet e tyre që komuniteti të integrohet sa më shumë në shoqëri.

2-Ekspozitë me piktura nga nxënësit, në të cilat ata kanë përcjellë mesazhin e tyre kundër dhunës.

3-Në orët e VJK me tema të planifikuara nxënësit janë përfshirë në diskutime të zjarrta për diskriminimin krahinor, fetar e gjinor.

Shpërndarja e fletpalosjeve kundër dhunës në komunitetin ka sensibilizuar atë për minimizimin e dhunës në familje.

Në takimet me prindër mësuesit kujdestarë kanë punuar për të ndërgjegjësuar ata që të dëgjojnë e respektojnë mendimet e dëshirat e fëmijëve.

Projekti i Save the Children ka bere qe procesi mesimor-eduikativ te kete aktivite, fushata sensibilizuese, sondazhe e trajnime. minimizimi i dhunes duket edhe ne mbarevajtjen ne oret e mesimit, ku ndihet nje fryme bashkepunimi midis mesuesve dhe nxenesve.

Gjate gjithë vitit te kaluar aktivitetet e lartpermendura kane shoqeruar proceset mesimore educative te shkolles sone, ndersa fundi i vitit u kurorozua me nje ativitet gjithperfishires, Panairi Popullor.

Ky eveniment u zhvillua pikerisht dite e fundit te shkolles dhe pati per qellim integrimin dhe pjesmarrjen ne kete aktivitet te perbashket, te te gjithë nxenesve, mesuesve dhe komunitetit.

Te gjithë ndame detyrat tona dhe punuam me vrull dhe entuziazem. Ate dite erdhem me heret se ditet e tjera

dhe pergatitem sallen e zhvillimit te aktivitetit. Oborri i shkolles, si ne feste, ishte i mbuhur me nxenes, mesues, prinder, te ftuar special nga pushteti lokal, perfaqesues te DAR, si dhe perfaqesues te Save the Children.

Pas nje pune te madhe lodhese e

argetuese, por dhe argetuese per zburimin e dhe sistemimin e ambientit ku do te zhvillohej aktiviteti, gjithcka ishte agti. Te ftuarit priteshin nga nxenesit e veshur me kostume popullore. Ne Panair u reklamuan punime dore te krahinave te ndryshme nga

duart e nxeneseve, nenave, gjysheve. Ub paraqiten pune artistike, druri, gatime te krahinave te ndryshme ku 8 kuzhinierë, nxënës të shkolles sone, servirin gatime te krahinave te ndryshme. Aktiviteti u shoqerua me kende te lendeve mesimore. Krahas ketyre, grupi artistik i shkolles, i kenaqi te pranishmit me interpretim te krijmtarise popullore e moderne.

Synimi i ketij aktiviteti ishte bashkepunimi dhe integrimi i nxenesve, mesuesve dhe komunitetit. Ky synim u realizua dhe te gjithë mbeten te kenaqur dhe me mbresa te pashlyeshme.

Falenderojme per ndihmen mesuesen e lendes gjuhes-Lumturi Ngjeci dhe mesuesen koordinatorë-Eliona Hoxha.



AKTIVITETI

Projekti i Save the Children ka bere qe procesi mesimor-eduikativ te kete aktivite, fushata sensibilizuese, sondazhe e trajnime në dobi të mbarëvajtjes mësimore



Në 100-vjetorin e Nënë Terezës



Te jesh bashkekombase me Gonxhe Bojaxhi eshte nje privilegj dhe nje krenari qe te shoqeron me nder kudo qe te shkosh, kudo qe te ecesh e te prezantohesh. Kjo grua e vogel ne shtat, por me zemer te madhe, aq sa mund te hyje ne te e gjithë bota e atyre qe kane nevojë per dashuri e perkujdesje, perkujtohet sot ne ambientet e shkolles sone "Xhafzotaj" me nje perulje dhe nderim te madh. T'u kushtosh jeten te tjereve, te varferve, te semureve do te thote qe ne nje fare menyre te heqesh dore nga vetja jote e nga kenaqesite e ndryshme te jetes

Pikerisht kesaj figure te vetmohimit iu perkushtua edhe java perkujtimore organizuar ne shkollen tone.

Konkretisht, me ndihmen e mesueses koordinatorë Liri Mema, mesueses se muzikes, letersise dhe drej-

toreshes se shkolles, u zhvillua nje aktivitet ne perkujtim te 100 vjeorit te lindjes se Nene Terezës. Ky aktivitet ishte kurorëzimi i shume oreve te lira qe shume klasa zhvilluan ne perkujtim te saj. Kënet e bukura, poezite e ndjera dhe domethenese te recituara me aq perkushtim nga nxenesit, pikturat e realizuara me aq talent si dhe te dhenat rreth jetes se Nene Terezës bashke me foto te ndryshme pershquan me gjalleri kete aktivitet modest. Minutat kalonin shpejt dhe ne ndjeheshim krenare qe ishim shqiptare, ashtu sic edhe ajo vete e pranonte. Te gjithë ndjeheshin te kenaqur dhe ne



shikonim ne syte e te pranishmeve nje miratim dhe vleresim per aktivitetin perkujtimor qe kishim pergatitur.

Ky nuk eshte aktiviteti i vetem qe kemi organizuar apo qe do organizojme. Vendi yne ka data e figura te shquara qe ne i perkujtojmë dhe i nderojmë.

Me respekt senati i shkolles 9 vjecare "Xhafzotaj"

